

VENDIM
Nr.804, datë 24.11.2011

**PËR LEJIMIN E REALIZIMIT TË PROCEDURAVE DHE SHTYRJEN E AFATIT TË
BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT E TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR
PËR DISA PROKURIME TË QENDRËS SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”,
TIRANË, SI AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, në vijim të pikës 3/ç të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, si autoritet kontraktor, të realizojë, brenda datës 10.12.2011, procedurat e prokurimit, si më poshtë vijon:

a) “Blerje materialesh mjekësore për hemodializën”, me fond limit 47 000 000 (dyzet e shtatë milionë) lekë, me TVSH.

b) “Blerje barnash të ndryshme për shërbimet mjekësore”, me fond limit 67 000 000 (gjashtëdhjetë e shtatë milionë) lekë, me TVSH;

c) “Blerje suturash qepëse (penj), për nevojat e shërbimeve të kirurgjisë”, me fond limit 27 000 000 (njëzet e shtatë milionë) lekë, me TVSH;

ç) “Blerje kitesh dhe reagentësh për laboratorët”, me fond limit 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë, me TVSH;

d) “Blerje filmash dhe kontrastesh për shërbimin e radiologjisë”, me fond limit 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, me TVSH;

dh) “Blerje gazoili dhe solari për nevojat e ngrohjes së shërbimeve në spital”, me fond limit 65 976 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, me TVSH.

Brenda këtij afati të përfshihen lidhja e kontratave përkatëse dhe botimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Përfshihet, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, lejohet t’i përdorë fondet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, brenda afatit të përcaktuar në po këtë pikë.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha